

VENDIM
Nr.860, datë 27.4.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1093, DATË 2.7.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE
TË PUNONJËSVE TË SISTEMIT TATIMOR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 025, datë 27.1.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e tatimeve”, e përmendur në pikën 1 të vendimit nr.1093, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me lidhjen me të njëtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara për rritjen e pagave, miratuar për vitin 2009.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 maj 2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E SISTEMIT TË TATIMEVE

				PAGA MUJORE			
EMËRTIMI				PAGA INDIVIDUALE		SHTESA E POZICIONIT	
KATEGORIA E VENDIT TË PUNËS	KATEGORIA E PAGËS	PAGA E GRUPIT (PG)		SHTESA VJETORE PËR VJETËRSI (SHV)	SHTESA PËR KUALIFIKIM (SHK)	SHTESA E POZICIONIT (SHP)	SHTESA PËR KUSHTE PUNE
1	2	3	4	5	6	7	8
	II-a	12 000	Drejtor i Përgjithshëm	2%		105 000	20 000
	II-b	12 000	Zv/ drejtor i përgjithshëm	2%		88 000	15 000
A	III-a	12 000	Drejtor drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme. Drejtor i drejtorisë rajonale	2%		69 000	15 000
B	III-a/1	12 000	Përgjegjës/shef sektori në Drejtorinë e Përgjithshme. Drejtor drejtorie në drejtorinë rajonale	2%		60 000	14 000
C.1	III-b	12 000	Përgjegjës/shef sektori/zyre në drejtorinë rajonale, inspektor i parë. Inspektor i auditit të brendshëm. Përgjegjës sektori në drejtorinë mbështetëse në Drejtorinë e Përgjithshme. Inspektor hetimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve	2%		52 000	12 000

	III-b	12 000	Përgjegjës zyre në Taks Forcë	2%		52 000	17 000
C.2	IV-a	12 000	Inspektor i dytë. Specialist në drejtorinë e përgjithshme Inspektor hetimi në Drejtorinë e Përgjithshme dhe në drejtoritë rajonale	2%		41 000	12 000
	IV-b	12 000	Specialist në drejtorinë e përgjithshme. Inspektor hetimi/specialist në drejtoritë rajonale	2%		31 000	10 000
C.3	IV-c	12 000	Specialist	2%		23 000	5000
D.1	IV-b	12 000	Sekretar në drejtorinë e Përgjithshme	2%		31 000	5000
	IV-c	12 000	Sekretar në drejtoritë rajonale	2%		23 000	5000
			Nëninspektor	1%		27 000	10 000